



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 60-të, të mbajtur më 28.01.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Procedura sipas lëndës me nr. 09-3577 / 1 datë 15.10.2020, i formuar pas denoncimit të dorëzuar kundër personit zyrtar -----, kryetar i komunës ----- **REFUZOHET.**

Pas kontrollit dhe analizimit të të dhënave, KSHPK-ja përcaktoi se nuk ka pretendime apo indikacione të qarta për veprime të paligjshme apo të palejueshme të personit zyrtar në ushtrimin e autoritetit publik dhe detyrës zyrtare.

Lënda me numër 09-3577/1 të datës 15.10.2020 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i panjohur, më datë 15.10.2020, është dorëzuar denoncim në të cilin pretendohet se Kryetari i Komunës ----- ka ndikuar në procedurën e punësimit të vajzës së tij në shkollën fillore - - - - - . Nuk ka të dhëna për të dhënat (emër dhe mbiemër) të vajzës së kryetarit të komunës. Më tej parashtruesi thekson se është i punësuar për një kohë të pacaktuar në të njëjtën shkollë dhe çdo vit shkollor është ri caktuar si mësues në fshatin ----- . ----- --. Me rastin e lirimit të vendit të punës në shkollën fillore -----, ajo plotësohej gjithmonë nga personeli mësimdhënës që shpërndahej në fshat. ----- . Por, në rastin konkret ka ndodhur një përjashtim, d.m.th. në momentin kur është liruar një punë për mësuesin pas ----- në shkollën fillore ----- . ---, vendin e punës e ka plotësuar vajza e kryetarit te komunës ----- . Parashtruesi mbeti duke dhënë mësim në fshatin -----, që është 14 km larg shtëpisë së tij. Sipas parashtruesit, në këtë rast ndikim të madh ka vetë kryetari i komunës.

Për arsye të kontrollimit të pretendimeve të bëra në denoncim, parashtruesi është kontaktuar përmes telefonit, pasi ka shënuar vetëm një numër telefoni.

KSHPK-ja kërkoi nga parashtruesi që të sqarojë denoncimin, gjegjësisht të dorëzojë informacione për vajzën e kryetarit të komunës. Deri në mbajtjen e seancës. Parashtruesi nuk i dorëzoi të dhënat e kërkuara.

Më tej, sipas pretendimeve në denoncim, vajza e kryetarit të komunës ----- është e punësuar në shkollën fillore -----, ku sipas procedurës së rregulluar me ligj Kryetari i Komunës ----- nuk ka kompetenca dhe nuk mund të përfshihet në procedurë, përkatësisht në rastin konkret nuk mund të konstatohet shkelje e nenit 74 nga LPKKI.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti: SM, bashkëpunëtor i larë
E kontrolluar nga: KZ- Udhëheqëse
Miratoi: M.r .SH.S, Anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHTETËRO
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
KRYETAR,
Biljana Ivanovska